

22 Dhjetor, 2022

Të Nderuar Prindër dhe Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Për shkak të motit të keq të parashikuar në zonën e Filadelfias, ndryshimet e mëposhtme në operacionet e shkollës dhe të drejtorisë do të jenë në fuqi për të Premten, 23 Dhjetor:

Të gjitha ndërtesat e shkollave të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias do të mbyllen për mësimin në - person, nesër, e Premte, 23 Dhjetor, dhe të gjitha orët mësimore do të zhvillohen virtualisht me udhëzime të drejtuara nga mësuesit. Studentët pritet të hyjnë në klasat e tyre në oraret e tyre normale për mësim virtual. Nxënësit duhet të marrin në shtëpi chromebook-ët e tyre për mësim virtual të drejtuara nga mësuesi ditën e Premte, 23 Dhjetor 2022. Familjeve u kujtohet se **chromebooks duhet të kthehen në shkolla kur studentët të kthehen nga pushimet të Mërkurën, 4 Janar 2023.**

Për më tepër, të gjitha ndërtesat dhe zyrat e Drejtorisë Arsimore do të mbyllen, duke përfshirë: Qendrat e Mbështetjes së Teknologjisë Familjare, zyrat në 440 North Broad Street dhe të gjitha ndërtesat shkollore. Përsëri, mësimet virtuale me udhëzime të drejtuara nga mësuesit do të mbahen për të gjitha shkollat në një orar normal shkollor. Gjithashtu, **të gjitha aktivitetet sportive do të anulohen për nesër.** Pesë vendet e Drejtorisë për testimet e COVID-19, të operuara nga DOCS Health, do të qëndrojnë të hapura nesër nga ora 9 a.m deri në 18:00 p.m

Ju lutemi, jini të sigurtë gjatë kësaj stuhie dimërore. Të gjithë nxënësve dhe familjeve të Drejtorisë sonë ju urojmë pushime dimërore të sigurt dhe të gëzueshme.

Sinqerisht,

Drejtorja Arsimore e Filadelfias